



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:031598

Datë: 30.03.2022

Numri i dokumentit: 02857033

PKR.nr.42/22

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Krimeve të Rënda**, me Kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor, Mirza Muric, në çështjen penale, kundër të akuzuarit H. J. nga fsh. .... K. Klinë, për shkak të kryerjes së veprës penale, *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 366 par.1, të KPPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, **PP/I. 11/22** të datës **25.02.2022**, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë **25.03.2022**, në prezencë të Prokurores së Shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarit H. J. me dt. **25.03.2022** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.**28.03.2022**, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***I akuzuari:***

**H. J.** i biri i D. dhe nënës M. e vajzërisë B. i lindur më dt., në fsh.... K-K, ku edhe banon, i pa punë, i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal - ..... posedon tel. me nr...../..... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

- Më parë dhe gjerë me datë 03.01.2022, rreth orës 21:45, në fshatin .... K. K, i pandehuri në kundërshtim me nenin 4 par. 1, pika 1.1.9 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), si armë e zjarrit e ndaluar për civil, ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë: një revole të modelit “”, cal. mm, me nr. serik me një karikator, një revole tjetër me gaz të modelit “”, me nr. serik me karikator, 10 (dhjetë) fishek të cal. mm, 3 (tre) fishek të cal. mm, 11 (njëmbëdhjetë) fishek të cal dhe 169 (njëqindëgjastë e nëntë) fishek me gaz të cal. mm, në atë mënyrë që, natën kritike në shtëpinë e të pandehurit, gjatë bastisjes nga ana e Policisë së Kosovës sipas urdhrat verbal nga gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës, në dhomën e katit të dytë të shtëpisë tij në një çantë krahu kanë gjetur revolet me të dhënat e sipërsënuara, e të cilat më pas bashkë me pjesët tjera përcjellëse janë sekuestruar nga ana e policisë,

- me çka ka kryer veprë penale “**Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21 par. 1, 38, 39 par.1 nënpar.1.3, 40 par.1 nënpar.1.3, 43 par.1, 69 par.1 dhe 3 nën par 3.6 dhe 3.7, 70, 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 360, 365, 366, 453 par.4 të KPPRK-së, të pandehurit H. J. i shqipton:

## **G J Y K O N**

- I.** Me dënim me gjobë në shumë prej 550 (pesëqind e pesëdhjetë) euro, të cilin dënim i pandehuri, ka për ta paguar në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.
- II.** Nëse i pandehuri refuzon, apo dështon ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj, me dënim burgimi, duke llogaritur një ditë burgimi shumë prej 20(njëzet) euro.
- III.** Obligohet të paguaj shpenzimet e procedurale ne formë të paushallit gjyqësorë në shumë prej 20 (njëzet) euro.
- IV.** Obligohet të paguaj taksen për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro në afat prej 30 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 366 par.3, të KPRK-së, ndaj të pandehurit H. J. i shqiptohet:

### **DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI**

**KONFISKOHET** një revole të modelit “”, cal. mm, me nr. serik me një karikator, një revole tjetër me gaz të modelit “”, me nr. serik me karikator, 10 (dhjetë) fishek të cal. mm, 3 (tre) fishek të cal. 7.62mm, 11 (njëmbëdhjetë) fishek të cal dhe 169 (njëqindegjashtë e nëntë) fishek me gaz të cal. 9mm.

**URDHËROHET** që një revole të modelit “”, cal. 9mm, me nr. serik me një karikator, një revole tjetër me gaz të modelit “”, me nr. serik me karikator, 10 (dhjetë) fishek të cal. 7.65mm, 3 (tre) fishek të cal. 7.62mm, 11 (njëmbëdhjetë) fishek të cal. 12 GA dhe 169 (njëqindegjashtë e nëntë) fishek me gaz të cal. 9mm, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen **PP/I. 11/22** të datës **25.02.2022**, kundër të akuzuarit H. J. ,nga

fsh..... K. Klinë, për shkak të veprës penale, “**Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366 par.1, të KPPK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 25.03.2022, e në të cilën kanë qenë të pranishëm, Prokurorja e shtetit, Lumturije Vuçetaj dhe i pandehuri H. J.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit së shtetit nën shenjen **PP/I. 11/22** të datës **25.02.2022**, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurores së shtetit, Lumturije Vuçetaj, si dhe të pandehurit H. J. gjykata është bindur, se, i akuzuari, e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit, i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata, ka udhëzuar të akuzuarin, për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë.

Prokurorja e Shtetit, në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit H. J. ka deklaruar se pajtohet me këtë pranim të fajësisë, meqenëse i njëjti këtë e ka bërë edhe në të gjitha fazat të mëhershme të procedurës penale, po ashtu meqenëse ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës, që ketë pranim të fajësisë ta aprovon.

Në vijim gjykata, duke shqyrtuar fajësinë, nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë, të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural, e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *Shënimi zyrtar i datës 03.01.2022; shënimi zyrtar i datës 04.01.2022; raporti i oficerit I. Xh. i datës 03.01.2022; raporti i policit hetues A. Ki datës 03.01.2022; njoftimi i datës 04.01.2022; deklarata e të pandehurit H. J. e dhënë në stacionin policor në K me datë 04.01.2022; procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave i datës 03.01.2022, lista e armëve të konfiskuara e datës 03.01.2022; urdhri nën shenjen UGJK.nr.01/22 i dt.05.01.2022; foto-albumi i përpiluar nga Njësia e Forenzikës i datës 03.01.2022; data-baza mbi të kaluarën kriminale e siguruar nga policia si dhe Aktakuza nën shenjen PP/II nr.51/2022 e dt.31.01.2022 për vepër penale “Dhuna në familje “nga neni 248 të KPRK-së dhe shkresat e tjera, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.*

Prokurorja e Shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *për të pandehurin ka konstatuar se ndaj të njëjtit në periudhën kohore kur është hetuar rasti kishte edhe një rast për të cilin është trajtuar për Dhune familjare me nr. të rastit ndërsa sipas evidencës në data bazën policore i njëjti nuk njihet si person i njohur për organet e rendit ndërsa i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim ta merr si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të cilin pranim e ka bere në të gjitha fazat e procedurës dhe sjelljen e tij korrekte, ndërsa si rrethana rëndësuese ta merr parasysh shkallen e*

*përgjegjesisë penale. Po ashtu propozoj që ti konfiskohet arma ashtu siç është propozuar edhe në aktakuzë.*

I pandehuri H. J. ka deklaruar se: *nuk kam çka të shtoj me shume përveç asaj që ka deklaruar PSH, i propozojë gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh rrethanat e lehtësuese të potencuara nga PSH, dhe të shqiptojë një dënim sa më të butë pasi që është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do ta përsëris veprimet e tilla, jam mbajtes i 5 fëmijëve të cilët janë në shkollim të sipër, jam punëtor fizik dhe kohë pas kohe punoj, realizoj të ardhurat mujore rreth 150-200.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, të KPPK-së.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se të i pandehuri, ka ekzistuar dashja, që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri, ka qenë i vetëdijshëm, për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e Prokurori i Shtetit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimin ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri e ka pranuar e fajësinë në të gjitha fazat e procedurës dhe ka pasur sjellje korrekte, ndërkaq rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjesisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimin e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimin me gjobe u morr konform nenit 40 par. 1 pika 1.3, të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimin nga gjoba në dënim burgimi do merret në aplikim të nenit 43 par.3, të KPRK-së, në rast kur i pandehuri nuk e paguan, refuzon apo dështon ta paguaj në shumën e cekur prej 550 (pesëqind e pesëdhjetë) euro si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi për paguarjen e shpenzimeve procedurale, si dhe taksave tjera për kompensimin e viktimave u morr konform nenit 450 par. 1, par.2 nën pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskim të armës dhe municionit, u morr konform nenit 366 par. 3, të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**DKR.nr.42/22 dt. 28.03.2022**

**Praktikanti gjyqësor,**  
Mirza Muric

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Dr.sc.Murat Hulaj

---

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.